REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr.2985/1 Prot. Vlorë më, 29.10.2026

VENDIM

Nr.31, datë 29/10/2026

PËR MIRATIMIN E SHTESËS SË MODULEVE PËR ZHVILLIMIN E SEZONIT TË VERËS PËR VITIN AKADEMIK 2025–2026

Në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; nenit 87, pikat 2, 5, 9, 10, 11 dhe 13, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të vendimit nr. 46, datë 28.08.2026, të Bordit të Administrimit, "Për miratimin e tarifave për zhvillimin e sezonit të verës dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të arkëtuara, për vitin akademik 2025-2026"; si dhe bazuar në shkresën e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, me nr. 737/1 prot., datë 26.10.2026, Rektorati, në mbledhjen e datës 29.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtimin e moduleve që do të zhvillohen gjatë sezonit të verës për vitin akademik 2025–2026, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.
2. Lista e moduleve të shtuara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet pjesë përbërëse e listës së moduleve të miratuara me Vendimin e Rektoratit nr. 18, datë 20.07.2026, "Për miratimin e zhvillimit të sezonit të verës dhe propozimin drejtuar Senatit Akademik të modaliteteve të zhvillimit të tij, për vitin akademik 2025–2026".
3. Për zhvillimin e moduleve të shtuara zbatohen tarifat dhe modalitetet e përcaktuara në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 46, datë 28.08.2026.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorët, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof.Dr. Aurela Saliaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORË

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

- DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Nr.	Kodi	Lënda
1	Ee 241	Sisteme dhe Sinjale
2	EGR 241	Baza e Sistemeve të Kontrollit
3	CS 397	Praktikë Profesionale